

# RAPORT STUDIMOR

## INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA ELBASAN



TJETËR VIZION  
QERSHOR 2022

## Table of Contents

1. HYRJE .....	3
2. <b>KONCEPTE DHE SHKURTIME</b> .....	5
3. <b>PROFILI I BASHKISË</b> .....	6
4. <b>METODOLOGJIA</b> .....	9
5. <b>ANALIZA E TE GJITHA FORMAVE PER INFORMIMIN, NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN</b> .....	10
5.1 <b>GJETJE NGA ANKETIMI ME NEPUNES TE BASHKISË</b> .....	13
5.2 <b>GJETJET NGA INTERVISTAT ME ANËTARET E KËSHILLIT BASHKIAK</b> .....	24
6. <b>KONKLUZIONE</b> .....	30
7. <b>REKOMANDIME</b> .....	31
8. <b>ANEKSE</b> .....	32

## 1. HYRJE

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen të njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatave të Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse në Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetarët pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet të punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

## 2. KONCEPTE DHE SHKURTIME

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

### 3. PROFILI I BASHKISË

Bashkia Elbasan shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Ajo është një nga Bashkitë e mëdha të vendit. Pas Reformës Administrative Territoriale Bashkia Elbasan njohu rritje drastike si në territor ashtu edhe në popullsi. Sipërfaqja e Bashkisë është 872 km<sup>2</sup> (është rritur përafërsisht 110 herë) dhe popullsia është 141.714 banorë sipas Censurit 2011, dhe 205.892 banorë sipas Regjistrimit Civil.

#### Qeverisja vendore

Bashkia e Elbasanit është pjesë e Qarkut Elbasan dhe përbëhet nga 18 njësi administrative dhe 116 fshatra. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan është i përbërë nga 51 anëtarë, nga të cilët 23 janë femra ose 45 %, çka tregon një rritje të pjesëmarrjes së grave në politike dhe vendimmarrje.<sup>1</sup> Bashkia e realizon komunikimin e saj me qytetarët edhe nëpërmjet përfaqësimit të komunitetit në Komisionin Këshillimor Qytetar Vendor (KKQV), një gupim vullnetar dhe konsultativ me bazë të gjerë.

#### Profili Ekonomik

Ekonomia e Bashkisë Elbasan mbizotërohet nga industria dhe bujqësia. Bashkia e Elbasanit ka të paktën 24 organizata të regjistruara të shoqërisë civile<sup>2</sup>, që mbulojnë një spektër të gjerë çështjesh, përfshirë: të drejtat e fëmijëve, të drejtat e gruas, të drejtat e komunitetit rom, familje në varfëri ekstreme, njerëz më aftësi të kufizuara, etj.

Të dhënat për Qarkun e Elbasanit tregojnë se përqindja e varfërisë është 10.7 % në krahasim me 14.3 % të varfërisë në nivel kombëtar. Në ndarjen e shpenzimeve sipas

---

<sup>1</sup> Bashkia Elbasan

<sup>2</sup> Të dhëna nga guida sociale e Qarkut Elbasan 2016

funksioneve, qëllimit të përdorimit të fondeve në dispozicion apo programeve buxhetore, struktura e shpenzimeve të Bashkisë së re Elbasan për vitet 2017-2018 rezulton të dominohet nga shpenzimet për funksionet e “mbrojtjes sociale” në masën 36.8%, më pas vjen sektori i planifikimit, menaxhimi & administrimi në masën 11.5%, vendin e 3të e zë infrastruktura, rrugët rurale me 10.7% si dhe shërbimet publike vendore në masën 8.1%.<sup>3</sup>

### **Struktura dhe vlerësime të Bashkisë Elbasan**

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur Programi i Transparencës për Bashkinë Elbasan. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit, në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI). Programi vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Bashkia Elbasan ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e LDI-së. Bashkia do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Qyteti i Elbasanit është fituesi i parë në Europën Jug-Lindore, i çmimeve për iniciativat Bashkiake për GENiYouth, prezantuar nga NALAS për iniciativat më të mira për përfshirjen e grave dhe të rinjve në qeverisjen lokale. Bashkia Elbasan u vlerësua me pikët maksimale për aktivitetit “Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor dhe buxhetimi me pjesëmarrje”.

Që prej vitit 2012 Bashkia Elbasan është e njohur për ngritjen dhe funksionimin e strukturës komunitare KKQV. Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor punon me autoritetet lokale duke ofruar rekomandime që kanë të bëjnë për çështje të komunitetit. Për disa vite me radhë KKQV është përfshirë në vlerësimin e komunitetit për qeverisjen, një metodologji që synon mobilizimin dhe përfshirjen e qytetarëve për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga të zgjedhurit vendor. Gjithashtu prej vitit 2016 në Bashkinë Elbasan funksionon dhe vepron edhe një strukturë tjetër këshillimore ajo e Këshillit vendor të sigurisë publike, strukturë aktive në identifikimin, raportimin dhe koordinimin e veprimeve për çështje të sigurisë publike në bashki.

### **Niveli i Transparencës në Bashkinë Elbasan**

Aktorë të ndryshëm kanë kryer monitorime, matje dhe vlerësime mbi nivelin e transparencës në nivel vendor, në të cilat ka qenë e përfshirë edhe Bashkia Elbasan: Referuar këtyre raporteve të vlerësimit situata në Bashkinë Elbasan është si më poshtë:

---

<sup>3</sup> Drejtoria e planifikimit të të ardhurave dhe buxhetit – Bashkia Elbasan

- Udhëzuesi mbi Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare në Shqipëri, hartuar nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe organizata Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim më [2018], e vlerëson Bashkinë e Elbasanit si një ndër Bashkitë më progresive në lidhje me praktikën të mira mbi procesin e zbatimit të buxhetimit me pjesëmarrje.<sup>4</sup> Bashkia e Elbasanit është një nga Bashkitë e para që kanë zbatuar buxhetimin me pjesëmarrje që nga viti 2004. Duke qenë të vetëdijshëm për nivelin e ulët të pjesëmarrjes së grave në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje në vitin 2012, Bashkia filloi të prezantojë buxhetim me pjesëmarrje me balancë gjinore në bashkëpunim me dy organizata lokale të shoqërisë civile.
- Sipas raportit të Vitit 2018 “Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë të Qendrës për Çështje të Informimit Publik” (INFOÇIP)<sup>5</sup>, Bashkia Elbasan renditet e 15-ta në programin e pikëzimit me 22 pikë, përkundëjt Bashkisë së Korçës me 30 pikë si Bashkia më e mirë e cilësuar.
- Sipas monitorimit online, të faqeve të internetit të Bashkive në Shqipëri të kryer nga rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Bashkia e Elbasanit renditet e 7-ta ndër 10-të Bashkitë me të mira me nivelin e transparencës online për V.2019, me një nivel të transparencës prej 50% (BIRN, 2019)<sup>6</sup> ku Bashkia Shkodër – me 69 % të indikatorëve të përmbushur, e ndjekur nga Bashkia Korçë dhe Bashkia Skrapar, janë tre njësitë e qeverisjes vendore me nivelin më të lartë të transparencës proaktive në rrjet.
- Sipas raportit të përgatitur nga Qendra Res Publica<sup>7</sup> dhe publikuar në Shtator 2019, në lidhje me indeksin e transparencës proaktive, Bashkia Elbasan vlerësohet e 2ta me 65 pikë duke qëndruar në renditje pas Bashkisë Shkodër. Në këtë rankim Bashkia Elbasan ka pas një përmirësim të dukshëm pasi në Janar 2019 ishte me 0 pikë dhe në Shtator të 2019 janë vlerësuar me 65 pikë, duke përshtatur programin e transparencës së institucionit dhe e ka publikuar në faqet online të Bashkisë.
- Bashkia Elbasan ka hartuar Planin Strategjik Kundër Korrupsionit për periudhën 2017-2019. Në lidhje me këtë plan nuk rezulton të jetë hartuar ndonjë raport monitorimi për zbatimin e aktiviteteve të synuara.

<sup>4</sup>Shqipëria Udhëzues mbi Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare.2018

<sup>5</sup> Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë 2018

<sup>6</sup>BIRN Albania.2019. Monitorimi 2019- Pushteti vendor nën lentën e të drejtës për informim

<sup>7</sup> ResPublica shtator2019, Indeksi i Transparencës



- Bashkia Elbasan ka hartuar Planin e Integritetit 2020-2022, i cili është një proces që zhvillohet për herë të parë. Plani i Integritetit (PI) është një dokument strategjik dhe një instrument parandalues për forcimin e integritetit të Bashkisë. Ai është një komponent shumë i rëndësishëm i proceseve të përgjithshme planifikuese të Bashkisë, i lidhur ngushtë me planin strategjik të Bashkisë.

## 4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Elbasan janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e Bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdoren për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 Bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka

zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

Ekspertet më pas përdorën edhe metoda krahasimore të konsultimit dhe analizimit të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) që bashkia disponon dhe kanë aksesueshmerinë nga publiku për t'u përdorur dhe informuar.

## 5. ANALIZA E FORMAVE TË INFORMIMIT, NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT

Informimi dhe komunikimi i vazhdueshëm në institucionet publike është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes për të drejtën për informim. Disa nga metodat e informimit dhe konsultimit që përdor Bashkia Elbasan janë si më poshtë:

### **Faqja Zyrtare Web e Bashkisë**

Në Faqen web të Bashkisë ka një faqe të veçantë kushtuar Programit të Transparencës. Ka një Koordinator për të Drejtën e Informimit dhe një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin. Të dhënat përkatëse të secilit koordinator gjenden në faqen e ëeb (emer mbiemer, numër telefoni dhe e-mail, orari i punës).

Në faqen e ëeb për informimin janë të përcaktuara procedurat për informimin.

Procedura që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion. - Qytetari paraqitet në zyren e Informimit Qytetar duke iu drejtuar punonjësit përkatës të marrjes së kërkesës, të cilët janë të organizuar sipas strukturës së përshkruar në Rregulloren e Bashkisë. - Kërkesa përmban emrin dhe mbiemrin e personit të interesuar, shoqëruar me kartën e identitetit, datën e kërkesës dhe numrin e saj, adresën e personit të interesuar si dhe numrin e kontaktit të tij.

- Përshkrimin e detajuar të informacionit që kerkohet, i ofrohet ndihmë nga specialist përkatës.

- Formatin në të cilin ai e kërkon përgjigjen e tij, postare, elektronikisht apo dhe në dorë (kur nuk mund të jepet ndryshe)

- Përshkruhet me kujdes çdo e dhënë që ndihmon apo plotëson informacionin e kërkuar.

- Një kopje e kërkesës i vihet në dispozicion qytetarit, e plotësuar me nr. e protokollit.

Në rast mosdhënie të një informacioni të kërkuar në mbështetje të ligjit të sipërcituar “Për të drejtën e informimit, çdo qytetar ka të drejtën e ankimit.

1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brënda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

### **Programi Transparencës**

Gjithashtu faqja e web-it i kushton vend të veçantë Programit të Transparencës dhe ka një tabelë përmbledhëse dhe sqaruese për këdo që ka nevojë të informohet. Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Bashkinë Elbasan. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit, në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Bashkia Elbasan ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Bashkia do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së bashkisë, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.elbasani.gov.al](http://www.elbasani.gov.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste / përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së AP -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Bashkia ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AP-së dhe përkatësisht: Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë; i saktë; i përditësuar; i thjeshtë në konsultim; i kuptueshëm; lehtësisht i aksesueshëm; i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

Në faqen e transparencës në webin e bashkisë ka një vend të veçantë për mekanizmat monitorues dhe mënyrën se si është organizuar ky mekanizëm. Faqa kushtuar raportit vjetor të monitorimit ekziston por kur klikohet nuk hapet.

Tabela përmbledhëse e Programit të Transparencës së Bashkisë Elbasan:  
Shkarkoni tabelën këtu.

<https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/PROGRAMI.pdf>

Ligji për të Drejtën e Informimit

Regjistri i Kërkesave 2020

Regjistri i Kërkesave 2021

Regjistri i Kërkesave 2022 nuk është hedhur pasi në ëeb-in e Bashkisë Elbasan është duke u përpunuar faqa e programit të transparencës, në ditët në vijim e gjithë faqa kushtuar transparencës do jetë e aksesueshme për të gjithë.

Formular Ankese – Kërkesa përmban emrin dhe mbiemrin e personit të interesuar, shoqëruar me kartën e identitetit, datën e kërkesës dhe numurin e saj, adresën e personit të interesuar si dhe numurin e kontaktit të tij. - Përshkrimin e detajuar të informacionit që kërkohet, i ofrohet ndihmë nga specialisti përkatës. - Formatin në të cilin ai e kërkon përgjigjen e tij, postare, elektronikisht apo dhe në dorë (kur nuk mund të jepet ndryshe) - Përshkruhet me kujdes çdo e dhënë që ndihmon apo plotëson informacionin e kërkuar. - Një kopje e kërkesës i vihet në dispozicion qytetarit, e plotësuar me nr. e protokollit.

**Rregullore për hetimin administrativ** të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Elbasan gjendet në rubrikën programi i transparencës dhe bazohet në ligjin nr 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”. Objekt I kësaj rregulloreje është përcaktimi I rregullave për procedurën e hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesve për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim te ligjit nr 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”.

Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në institucionin e Bashkisë Elbasan gjendet në rubrikën programi I transparencës dhe bazohet në ligjin nr 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”.

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

**Facebook:** Bashkia Elbasan ka dhe nje faqe zyrtare FB në të cilën ndahet informacioni për çdo takim, lajmerime për mbledhje, takime me publikun, takime të Kryetarit të Bashkisë, etj.

Gjithashtu facebook i Kryetarit të Bashkisë Elbasan përmban një informacion të gjërë për aktivitetet e ndodhura në kohë reale të Bashkisë Elbasan.

### **Mjetet e Informimit**

Me hyrjen në fuqi të Reformës së re Administrativo-Territoriale, Ligji nr.115/2014 për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësitë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë, ofrimi i shërbimeve për qytetarët në njësitë administrative, kërkon zbatimin e një sistemi informatik, i cili zbaton procedurat e miratuara paraprakisht nga Bashkia (rregulloren e shërbimeve administrative dhe manualin përkatës). Bashkia Elbasan, me njësitë e saj administrative ofrojnë shërbime sipas modelit të zyrave me një ndalesë duke garantuar kosto të ulët shërbimi dhe kohë më të shkurtuar, duke rritur transparencën dhe cilësinë e shërbimeve të saj.

### **Komunikimet e Drejtpërdrejta**


Komunikimi i drejtpërdrejtë ose ndryshe ballë për ballë është një nga mënyrat më të përdorura dhe ndoshta më të besueshme në transmetimin e mesazhit. Kjo pasi në këtë mënyrë aktorët e komunikimit kuptojnë më mirë reagimin që marrin nga njëri-tjetri. Ky lloj komunikimi është edhe një nga mënyrat që Bashkia Elbasan ka zgjedhur të komunikojë me qytetarët e saj. Komunikimin ballë për ballë Bashkia Elbasan e realizon përmes dëgjësive publike të cilat zhvillohen në institucion në ditë të caktuara, për çdo problematik apo çështje që kanë qytetarët. Gjithashtu në hyrje të Bashkisë janë të vendosura tabelat e njoftimeve të ndara sipas kategorisë së njoftimeve. Edhe në hyrje të NJA-ve të intervistuar ka tabela për njoftimet e publikut. Njoftimi I fundit është në dt 25 Qershor në NJA Shirgjan.

## **6. GJETJE NGA ANKETIMI ME NEPUNES TE BASHKISË**

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Elbasan përfshiu 11 nëpunës si: Koordinatori për Njoftim; Koordinatori për Informim dhe Konsultim; Shefi i kabinetit të kryetarit/kryetares; Drejtori që lidhet me mirëmbajtjen e **ëeb**/mediave sociale; Pergjegjësi/ja e One Stop


Shop; Nënkryetari përgjegjës për marrëdhëniet me publikun dhe 5 administratorë të Njësive Administrative Papër, Shirgjan, Funar, dhe 2 njësive të bashkisë qytet. Të intervistuarit janë punonjës të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm të Bashkisë Elbasan të cilët punojnë dhe/kanë kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.



Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” në Bashki të anketuarit janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore. Përsa i përket fushës se sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore nga 11 intervistat e kryera 10 janë përgjigjur se janë shumë të rëndësishëm dhe vetëm 1 mendon se është i rëndësishëm;

A e njihni bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore?



## KUADRI LIGJOR

Vlerësimi mbi rëndësinë e të gjitha këtyre proceseve që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, kërkon dhe njohje të mirë të nëpunësve të Bashkive me aktet ligjore përkatëse. Pyetjes se sa e njohin bazën ligjore për informimin, njoftimin dhe konsultimin e publikut në nivel vendor 10 janë përgjigjur se e njohin shumë mirë dhe vetëm 2 janë përgjigjur se e njohin mirë;

Përsa i përket vlerësimit të tyre për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor 11 të intervistuarit janë përgjigjur që kuadri ligjor është i qartë dhe i plotë.


Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor?



Pyetjes se nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme si: 6 të intervistuar mendojnë se nuk ka nevojë për rishikime dhe plotësime, 2 të intervistuar mendojnë se kuadri ligjor është në lartësinë e duhur dhe vetëm 3 prej tyre kanë dhënë përgjigje specifike si: njëri mendon se duhet të shtohen metodat dhe mënyrat për informin, tjetri të gjenden metoda të reja për informim dhe një tjetër mendon të gjenden mundësi të reja dhe alternative për mënyrën e informimit.



Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?



- Nuk ka nevojë për rishikime dhe plotësime
- Eshtë në lartësinë e duhur
- Duhet të shtohen metodat dhe menyrat për informim
- Te gjenden metoda të reja për informim
- Te gjenden mundësi të reja dhe alternative për menyrën e informimit


## Koordinatorët për Njoftimin e Konsultimin

Koordinatorët për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike

Pyetjes se a ka koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik dhe koordinator për transparencën të 11 pjesëmarrësit në anketim, në masën 100% janë përgjigjur po dhe po kështu në masën 100% vjen dhe rezultati në lidhje me rolin që kanë në Bashki.

## Koordinator për njoftimin, konsultimin dhe transparencën

6. A ka koordinator/e për transparencën në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulon?
5. A ka koordinator/e për njoftimin dhe konsultimin publik në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulon





## Mjetet dhe instrumentat për Njoftimin e Qytetarëve

Pyetjes se cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin e qytetarëve për përfshirjen e tyre në vendimarrje 4 nga të intervistuarit i janë përgjigjur se 5 metodat më të përdorura janë:

- Njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë
- Njoftim në mediat audio-vizive lokale
- Njoftim në mediat sociale (Facebook, etj)
- Njoftime individuale përmes postës
- Njoftime individuale përmes postës elektronike

Dy nga të intervistuarit mendojnë se 4 janë format më të përdorura si:

- Njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë,
- Njoftim në mediat audio-vizive lokale,
- Njoftim në mediat sociale (Facebook, etj),
- Njoftime individuale përmes postës elektronike,


Katër nga të intervistuarit mendojnë se 3 janë format më të përdorura si :

- Njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë,
- Njoftim në mediat audio-vizive lokale,
- Njoftim në mediat sociale (Facebook, etj),


Njëri nga të intervistuarit mendon se 2 janë format më të përdorura si:

- Njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë,
- Njoftim në mediat sociale (Facebook, etj).

Nga analiza e bërë më sipër na rezulton se mjetet më të përdorura për informimin e qytetarëve ekzistojnë në bashkinë qendrore por edhe në njësitë administrative duke u përditësuar sa herë që ka informime dhe njoftime të reja.



Pyetjes se sa njoftime të publikuara në tabelat e njoftimeve dhe online janë bërë gjatë vitit 2021, edhe pse i janë përgjigjur të gjithë të intervistuarit, vërehet një mospërputhje në perceptimin e tyre për numrin e njoftimeve, sepse 46% përgjigjen se janë 71 njoftime, 9% e të intervistuarëve përgjigjen që 143 njoftime (kështu është përgjigjur administratori i NJA nr.1 Elbasan), dhe më pas nga 18% e të intervistuarëve vlerësohet se janë publikuar 50 deri në 70 njoftime.



## Regjistri elektronik



Mbajtja dhe publikimi i regjistrit elektronik është një detyrim ligjor që duhet përmbushur nga çdo institucion publik, por që në praktikë nuk gjen zbatim në çdo Bashki në vend. Duket që ky nuk është rasti i Bashkisë Elbasan e cila e ka një regjistër elektronik online.

Por ka konfuzion në lidhje me strukturën përgjegjëse në Bashki për përditësimin e regjistrit elektronik. Ky konfuzion mbështetet edhe nga përgjigjet e marra nga nëpunësit e Bashkisë, pasi tre prej tyre janë përgjigjur që regjistrin e plotësojnë punonjësit e zyrës së medias;


tre punonjësit e zyrës së medias dhe IT në Bashki;

tre janë përgjigjur zyra e informacionit;

dy janë përgjigjur punonjësit e zyrës së one stop shop.




Pyetjes, a është i publikuar ky regjistër online 7 janë përgjigjur po dhe 4 prej tyre në pozicionin e Administratorëve të NjA janë përgjigjur jo.



### Instrumentat e Informimit

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Elbasan për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e zyrave me një ndalesë dhe këndet e informimit në Bashki të cilat janë vlerësuar nga 100% e pjesëmarrësve në anketim.

Mediat sociale, faqja zyrtare e Bashkise, mediat audio-vizive janë vlerësuar më pak nga një përqindje më e vogël e të intervistuarëve. Shtatë prej tyre mendojnë se mjetet për informimin e qytetarve janë edhe materialet informuese, regjistri elektronik dhe vetëm 4 mendojnë se përdoren edhe botimet e Bashkisë.




### Lehtësia e aksesit të dokumentacionit nga qytetarët

Në lidhje me pyetjen se a kanë mundësi qytetarët të marrin apo të aksesojnë lehtësisht dokumenta dhe informacione që ju duhen pranë Bashkisë të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur po, pasi procedurat për marrjen e dokumenteve dhe informacioneve janë lehtësisht të aksesueshme.

Në lidhje me pyetjen se a publikohen aktet e Bashkisë tuaj në faqen zyrtare të internetit të gjithë të intervistuarit mendojnë që po publikohen.

Ndërsa pyetjes se a afishohen aktet e Bashkisë tuaj në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike të gjithë i janë përgjigjur po afishohen.



## Programi transparencës

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar Programin e Transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Program Transparence quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga Bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të Bashkisë dhe njësive administrative.


Përsa i përket pyetjes se a keni hartuar dhe publikuar programin e transparencës të gjithë të intervistuarit 100% janë përgjigjur po. Në lidhje me pyetjen se a keni hartuar apo publikuar raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes të intervistuarit janë përgjigjur të gjithë se Bashkia publikon raporte vjetore për transparencën.

Në lidhje me pyetjen se çfarë përfshihet në raportet vjetore të transparencës në procesin e vendimmarrjes pothuajse 100% e të anketuarëve mendojnë se këto raporte përfshijnë numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit.

70% e të anketuarëve mendojnë se ne raport përfshihet numri i takimeve publike të organizuara,

30% mendojnë se përfshihet numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, dhe vetem 9% mendojnë se në raport përfshihet edhe numri i

rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes.



### Sfidat dhe rekomandimet për njoftimin dhe informimin e publikut


Në lidhje me pyetjen mbi disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur për njoftimin dhe informimin e publikut përgjigjet e të intervistuarve, vënë në dukje sfidat e mëposhtme:

- aksesit dhe paaftësia e qytetarëve në përdorimin e teknologjisë;
- mungesa e internetit në zonat malore;
- qytetarët nuk kanë interes dhe nuk vijnë në takime.

### Trajnimet mbi Detyrimet Ligjore mbi Informimin Publik

Pyetjes a keni marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik të gjithë të intervistuarit i janë përgjigjur po kemi marrë;

21. A keni marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik



trajnime.

Pyetjes se cilat do të ishin nevojat për trajnime në të ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin dy prej të intervistuarve janë përgjigjur se ka nevojë të trajnohen kur ka procedura të reja lidhur me informimin, njoftimin dhe konsultimin; një tjetër mendon se duhet të bëhen sa më shumë trajnime; katër të intervistuar mendojnë të ketë trajnime mbi teknologjinë dhe metodat e reja në fushën dixhitale, dy sugjerojnë trajnime mbi metoda të reja të informimit më efikas të publikut, mbi procedurat e reja për njoftimin dhe konsultimin e publikut dhe vetëm një i intervistuar mendon se nuk ka nevojë për


## 7. GJETJET NGA INTERVISTAT ME ANËTARET E KËSHILLIT BASHKIAK

Anketimi me Këshillin Bashkiak Elbasan përfshiu 5 anëtarë të KB së bashku me Sekretarin e Këshillit. Të intervistuarit përfaqësojnë komisione apo pozicione të caktuara të cilat kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë, përfshirë Këshilli Bashkiak Elbasan për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

### Rëndësia e Njoftimit, Informimit dhe Konsultimit në Vendimmarrjen Vendore

1. Në opinionin tuaj si këshilltar vendor, sa i rëndësishëm është nj oftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore



Të intervistuarit e Këshillit Bashkiak Elbasan e vlerësojnë në masën 100% rëndësinë e njoftimit dhe informimit në vendimmarrjen vendore. Sipas tyre, njoftimi i publikut për mbledhjet e Këshillit realizohet në forma të ndryshme duke e parë si një element shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme konsultuese.



### Baza Ligjore për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin

Informimi i publikut nga Këshilli Bashkiak bëhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 dhe Ligjin 119/2014 'Për të drejtën e Informimit' dhe rregullat e përcaktuara nga vetë Këshilli Bashkiak. Këshilli mundëson ngritjen e një sistemi të integruar të prodhimit dhe dhënies së informacionit për publikun bazuar mbi aktet ligjore ne fuqi.

Pyetjes se sa e njohin bazën ligjore për informimin, njoftimin dhe konsultimin e publikut në nivel vendor 60 % e të anketuarëve janë përgjigjur se e njohin shumë mirë dhe 40% janë përgjigjur se e njohin mirë. Ndërkohë vlerësimi mbi kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe



informimin e publikut në nivel vendor nga të gjithë të intervistuarit vlerësohet i qartë dhe i plotë;



## Rregulloret e Këshillit Bashkiak

Këshilli Bashkiak Elbasan ka miratuar disa rregullore të cilat janë në funksion të mirëfunksionimit të tij si edhe rregullore të tjera si rregullorja për marrëdhëniet me publikun dhe median, rregullorja për etikën dhe rregullorja e kërkesë-ankesave. Këto instrumenta synojnë të rregullojnë dhe lehtësojnë procese dhe funksione të caktuara të Këshillit Bashkiak.

Pyetjes a keni rregullore dhe procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit të njoftimit dhe informimit të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur se kanë rregullore dhe procedura të brendshme ndër të cilat përmendin:

- rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak,
- rregullore për informimin dhe konsultimin me publikun;
- rregullore për kërkesa, ankesa, dhe peticione.

Në lidhje me pyetjen se si i vlerësojnë ata rregulloret e Këshillit Bashkiak dhe sa janë ato të qarta e të plota, 100% përgjigjen që janë të qarta.



Të intervistuarit kur janë pyetur se çfarë mendojnë që ka nevojë për rishikim apo plotësime për rregulloret e Këshillit Bashkiak dhe cilat janë rekomandimet e tyre në këtë drejtim, 4 prej tyre janë përgjigjur se nuk ka nevojë për rishikim apo plotësime dhe vetëm 1 mendon se ka nevojë për rishikime dhe plotësime duke rekomanduar se ka nevojë të ndiqen dhe t'u kushtohet më shumë vëmendje ankesave të qytetarëve në rrjetet sociale sidomos në FB, pasi kalojnë të pashqyrtuara dhe në këtë mënyrë rritet pakënaqësia e qytetarëve dhe bie cilësia e shërbimeve të ofruara.

### Bashkëpunimi me Bashkinë për njoftimin dhe informimin

Të intervistuarit janë përgjigjur në masën 100% pozitiv dhe vlerësues sa i përket bashkëpunimit midis Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Elbasan për procesin e njoftimit dhe informimit me publikun.




Më tej të intervistuarit janë pyetur se nëse kanë një bashkëpunim midis Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë dhe cilat janë mënyrat e realizimit të këtij bashkëpunimi. Kësaj pyetje të intervistuarit i janë përgjigjur në forma të ndryshme duke renditur edhe mënyrat e njoftimit të tyre si këshilltarë nga Bashkia. Të intervistuarit

kanë renditur disa forma sesi vetë ata njoftohen nga stafi Bashkisë:

- Takime të perbashkëta
- Njoftohemi me email
- Nëpërmjet sekretares
- Nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë

- FB të këshillit Bashkiak
- Takime direkte dhe komunikime zyrtare.

## Publikimi i Njoftimeve për Mbledhjet e Këshilli Bashkiak




Pyetjes a publikohet njoftimi për mbledhjen e Këshillit në vende të caktuara për këtë qëllim dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore, 4 nga te intervistuarit i janë përgjigjur po dhe 1 jo. I intervistuari që është përgjigjur jo, ka komentuar se njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan dhe në faqen e facebook të Këshillit. Në lidhje me pyetjen në dijeninë tuaj, a

përmban njoftimi për mbledhjen e këshillit datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes te intervistuarit janë përgjigjur se informacioni është i plotë.

## Publikimi i Akteve të Këshilli Bashkiak

Neni 18 i Ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë Ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: “Aktet e Këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, Këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo Bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë Këshilli përkatës për këtë qëllim”.




Pyetjes në dijeninë tuaj aktet e Këshillit Bashkiak publikohen, shpallen në faqen zyrtare të internetit apo në vende publike të caktuara nga Këshilli me akses të lirë publik i janë pergjigjur të 5 të intervistuarit duke pohuar ato se ato publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe 2 prej tyre kanë zgjedhur të dyja opsionet në faqen zyrtare të internetit dhe në vende publike të caktuara nga këshilli me akses publik. Përsa i përket burimeve të nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit të publikut,

pjesa më e madhe mendojnë se Këshilli Bashkiak i ka këto burime.

### Njoftimi dhe Informimi i Publikut

Pavarësisht se të intervistuarit e përfshirë në anketim janë shprehur se Këshilli Bashkiak Elbasan i ka të gjitha burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit për publikun, praktikisht kjo nuk është e mundur. Për ta realizuar në të gjithë dinamikat e veta ashtu siç edhe parashikohet në ligj, këto procese kërkojnë burime financiare dhe njerëzore të paracaktuara dhe në dispozicion të Këshillit në buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm.


Pyetjes në dijeni tuaj, cilat janë mjetet që përdor Këshilli për njoftimin dhe informimin e publikut, 33% e zë njoftimi nëpërmjet mediave sociale si Facebook, 27% mendojnë me njoftime individuale përmes postës apo takimeve direkte, 13% njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë, 7 % njoftim në mediat audio-vizive lokale, dhe 20 % metoda e njoftimeve individuale përmes postës elektronike.



Tre të intervistuar janë shprehur se ka një Regjistër Elektronik i cili përditësohet dhe dy të intervistuar mendojnë se nuk ka një regjistër elektronik.

Lidhur me programin e transparencës të gjithë të intervistuarit shprehen se Bashkia ka një program transparence i cili zë një vend të veçantë në faqen zyrtare të Bashkisë.

Në lidhje me trajnimet për detyrimet ligjore lidhur me informimin e publikut % më e madhe e të intervstuarëve mendojnë se kanë marrë trajnime dhe një pjesë e vogël mendon që jo të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak janë trajnuar.



## 8. KONKLUSIONE

### **Nga analiza e pyetësoreve me përfaqësuesit e Bashkisë:**

- Njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimarrjen vendore është vlerësuar si shumë i rëndësishëm nga të gjithë të intervistuarit
- Bazën ligjore për informimin dhe konsultimin e zotërojnë 80% e të intervistuarve dhe vetëm 20% nuk e njohin mirë.
- Kuadri ligjor është i qartë dhe i plotë dhe nuk ka nevojë për plotësime mendojnë përqindja me e madhe e të intervistuarve dhe një pjesë e vogël rekomanojnë që të plotësohet me metodat e reja të konsultimit dhe informimit.
- Metodatat më të përdorura për njoftimin dhe konsultimin me publikun janë njoftimi në vendet e posaçme nga Bashkia, në mediat audio vizive dhe në faqen zyrtare të FB të Bashkisë.
- Në ëëbin e Bashkisë ka të afishuar një Regjistër Elektronik i cili azhurnohet sistematikisht.
- Ka konfuzion në lidhje me personat përgjegjës për të plotësuar regjistrin elektronik.
- Bashkia ka hartuar dhe ka të publikuar programin e transparencës dhe ka hartuar e publikuar raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes.
- Sfidat dhe vështirësitë që kanë ndeshur për njoftimin dhe informimin e publikut lidhen me aksesin e qytetareve në përdorimin e teknologjisë, mungesa e internetit në zonat malore.

### **Me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak**

- Njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimarrjen vendore është vlerësuar si shumë i rëndësishëm nga të gjithë të intervistuarit dhe bazën ligjore për informimin dhe konsultimin e njohin 60% e të intervistuarve, 40% nuk e njohin mirë.
- Rregullorja e Këshillit Bashkiak lidhur me marrëdhënjet e KB me publikun, median dhe paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare është e qartë dhe e plotë.
- Njoftimi për mbledhjen e këshillit publikohet në vende të caktuara për këtë qëllim dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, orën, rendin e ditës dhe vendin e takimit.
- Njoftimi për mbledhjen e Këshillit publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në faqen e FB të Këshillit.
- Aktet e Këshillit Bashkiak publikohen në masën më të madhe në faqen zyrtare të ëëbit dhe më rrallë në vende publike, të caktuara nga Këshilli me akses të lirë publik;

- Këshilli Bashkiak ka burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit të publikut, por një pjesë e vogël mendojnë se nuk ka.
- Mjetet më të shpeshta që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin dhe informimin e publikut janë njoftimi në mediat sociale Facebook, njoftime individuale përmes postës apo takimeve direkte, njoftime individuale përmes postës elektronike, njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë dhe përdorim më të vogël ka njoftimi në mediat audio-vizive lokale;
- Pjesa më e madhe e anëtarëve të Këshillit Bashkiak (të intervistuarit) janë trainuar në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik dhe një pjesë e vogël mendon që ka një pjesë të konsiderueshme të antarëve të Këshillit Bashkiak që nuk është trainuar.

## 9. REKOMANDIME

- Të qartësohet struktura përgjegjëse për Regjistrin Elektronik në Bashki.
- Të trajnohen i gjithë stafi i Bashkisë dhe antarë të Këshillit Bashkiak që të njohin më mirë bazën ligjore në lidhje me informimin, njoftimin dhe konsultimin e publikut.
- Te trajnohen përfaqësuesit e Bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak lidhur me: procedurë të reja të informimit, njoftimit dhe konsultimit të publikut, mbi teknologjinë dhe përsosshmërinë në fushën dixhitale.
- Informimi dhe konsultimi i publikut të bëhet në mënyrë konstante dhe në të gjitha lagjet duke i dhënë prioritet njoftimit të qytetarve, gjetjen e metodave të reja të informimit dhe rritjen e interesit të tyre për të marrë pjesë në takime.
- Njoftimet për qytetarët të bëhen sipas lagjeve dhe me frekuencë më të shpeshtë duke përdorur të gjitha kanalet e komunikimit të aksesueshme nga qytetarët.
- Informimi dhe konsultimi i publikut të bëhet në mënyrë konstante, të gjenden metoda alternative të informimit.

## 10. ANEKSE

### 10.1 PYETËSORI ME DREJTUES DHE NËPUNËS TË BASHKIS

[..\Pyetesore per intervistat me Perfagesuesit e Bashkise.docx](#)

### 10.2 PYETËSORI ME ANETARE TË KESHILLIT BASHKIAK

[..\Pyetesore per intervistat me Keshillin Bashkiak.docx](#)